



**BASHKIA LEZHE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Lezhe, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Punime ndertimi per nevoja te Ujitjes”, i ndare si me poshte vijon:

- Punime për “Kalimin e Lumit Gjadër, me Tub çeliku me qëllim vaditjen e tokave bujqësore në fshatin Gjader, Nj. Administrative Dajç”,
- Punime për “Kalimin e Lumit Gjadër, me Tub çeliku me qëllim vaditjen e tokave bujqësore në fshatin Dajç”,
- Ndertimi i Stacionit të Pompave në fshatin Gramsh – Mabë,

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 45000000-7

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 21,602,338.63 (njetzet e nje milion e gjashteqind e dy mije e treqind e tridhjetete e tete pike gjashtedhjetete e tre) Lek pa Tvsh, nga keto:

- Fondi Limit per “Punime për “Kalimin e Lumit Gjadër me Tub çeliku me qëllim vaditjen e tokave bujqësore në fshatin Gjader, Nj. Administrative Dajç” eshte vlere prej 1,517,005.83 (nje milion e peseqind e shtatembedhjetete mije e pese pike tetedhjetete e tre) Lek pa Tvsh,
- Fondi Limit per “Punime për “Kalimin e Lumit Gjadër me Tub çeliku me qëllim vaditjen e tokave bujqësore në fshatin Dajç” eshte vlere prej 1,275,781.67 (nje milion e dyqind e shtatetdhjetete e pese mije e shtateqind e tetedhjetete e nje pike gjashtedhjetete e shtate) Lek pa Tvsh,
- Fondi Limit per “Ndertimin e Stacionit të Pompave në fshatin Gramsh – Mabë” eshte vlere prej 21,602,338.63 (njetzet e nje milion e gjashteqind e dy mije e treqind e tridhjetete e tete pike gjashtedhjetete e tre) Lek pa Tvsh,

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit (Shtojcat).

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kërkohej një operator ekonomik i cili të ketë minimumin e kërkuar duke marrë në konsideratë objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.2** Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

*Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.3** Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Pagesa e taksave është një detyrim ligjor dhe meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;

6. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikaten e perhershme te marrjes ne dorezim  
-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Kontratë sipermarrje;
  2. Leje per kryerje punimesh
  3. Situacionin përfundimtar;
  4. Fatura tatimore te deklaruar ne organet tatimore;
  5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e perhershme të marrjes ne dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

**2.3.2** Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

## **PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI**

- NP- 3 A** Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada  
**NP- 7 B** Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

**NP- 11 A** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

**NP- 12 A** Punime të inxhinierisë mjedisore

### **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

**NS- 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve

**NS- 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

**NS- 14 A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

**NS- 18 A** Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton *“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në pdrputhje me standartet kombëtare ose europiane.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve ne prevenivin e hartuar nga projektuesi pasi aktivitetet kryesore qe do te beje Kontraktori per perfundimin me sukses te punimeve sipas kontrates ne kete objekt jane:

➤ Mobilizimi

➤ Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve

- Aktivitetet e Punimeve Ndertimore
- Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut
- Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilesise se materialeve

Klasat janë përcaktuar referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008, në proporcion me preventivin e punimeve dhe fondin limit dhe jane analizuar ne tabelen e meposhteme:

Kategoria e Licenses	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlera e punimeve në preventiv, sipas kategorisë përkatëse
<p><b>NP- 3 A</b> Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada</p>	<p>Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.</p> <p>Ne Preventivin e punimeve parashikohen</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. PUNIME SHITESASH</li> <li>2. PUNIME BETONI DHE BETONARMEJE</li> <li>3. PUNIME MURATURE TULLE</li> <li>4. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI</li> </ol>	<p>0-20,000,000 lek</p>
<p><b>NP- 7 B</b> Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje</p>	<p>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.</p> <p>Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura,</p>	<p>21- 50 milion lekë</p>

	<p>rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.</p> <p>Punimet konsistojnë në rehabilitimin e stacionit të pompimit në Fshatin Gramsh, Bashkia Lezhe.</p>	
<p><b>NP- 11 A</b> Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.</p>	<p>Konsiderohen punimet për Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji të tensionit, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.</p> <p>Në preventivin e punimeve parashikohen punime elektrike dhe vendosjen e transformatorit dhe linjes elektrike.</p>	<p>0-20,000,000 lek</p>
<p><b>NP- 12 A</b> Punime të inxhinierisë mjedisore</p>	<p>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimin të kompaktësimin të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitetin botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrit hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpave rrugore, hekurudhor</p>	<p>0-20,000,000 leke</p>

	të karrierave dhe mbetjeve inerte.  Ne prventivimin e punimeve parashikohen punime per shpyllezimin	
<b>NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve</b>	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime per prishje shtresa betoni dhe mur.	80,000 leke
<b>NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.</b>	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime murature tulle, Tavani dhe suvatimi, dyer dritare, punime bojatisje etj.	0-20,000,000 lek
<b>NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.</b>	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime per instalime elektrike per ndricim	0-20,000,000 lek
<b>NS- 18 A Punime topogjeodezike.</b>	<p>Theksojme se kerkesa per kete kategori dhe klase license eshte bere dhe ne perputhje me VKM Nr. 42, date 16.01.2008, “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, ku percaktohet se:</p> <p>N.S - 18 "Punime topogjeodezike", konsiderohet <i>zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.</i></p> <p>Sa i perket klases "A" se kerkuar, theksojme se kjo fushe specifike nuk shprehet ne zera konkret te preventivit, por eshte komplekse dhe gjithepershires ne te gjitha fazat e zbatimit te</p>	0-20,000,000 Lek

	<p>projektit, nga momenti i marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit deri ne perfundimin e punimeve dhe dorezimin prane AK-se, te sheshit te ndertimit, e per rrjedhoje kjo kerkese eshte ne proporcion me natyren, volumin dhe kompleksitetin e kontrates dhe kategorite dhe klasat e licencës janë ne proporcion me raportet teknike, specifikimet teknike objekt i kësaj kontrate si dhe konform përcaktimeve referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008.</p>	
--	--	--

**2.3.3** Operoret Ekonomike duhet te kene një punësim mesatar të paktën 21 (njetzet e nje) personave të siguruar për periudhen Janar 2026 – Mars 2026.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kerkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit te mesiperme per numerin minimal te punonjesve duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, raportit teknik, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe

profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.3.4** Operatorët Ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë dhe të figurojnë në Licensën e kompanisë si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Elektrik	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Mekanik	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Gjeodet/Topograf	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Mjedisi	1 (nje)	Diplome Universitare

-Per stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë në listepagesat e kompanisë së minimalisht për periudhën Janar 2026 – Mars 2026.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i dryshuar, si dhe ligjin nr. 8402, date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit” i ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinierik për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm në lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, date 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar parashikohet se: “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.”

Sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e punëve të objektit të prokurimit, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve. Për më tepër duke qenë se këto punime janë të një rëndësie të vecante dhe në të njëjtën kohë konsistojnë në rehabilitimin e stacionit të pompimit vlerësohet e nevojshme që të kerkohen specialist të fushave inxhinierike si: Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Elektrik dhe Inxhinier Mekanik dhe Inxhinier Mjedisi

Ne lidhje me kërkesen e Drejtuesit Teknik Inxhinier Ndertimi, njesia prokurimit ka marre ne konsiderate se projekti perfshin punime ndertimore per rehabilitimin e stacionit te pompimit dhe kalim tubacioni celiku.

Ne lidhje me kërkesen e Drejtuesit Teknik Inxhinier Hidroteknik thkesojme se punimet kane per qellim furinizimin me uje te zones se Gramsh dhe eshte e nevojshme qe keto punime te kryhen ne prani te Inxhinierit Hidroteknik.

Ne lidhje me kërkesen e Drejtuesit Teknik Inxhinier Elektrik njesia e prokurimit mbane ne konsiderate se projekti per rehabilitimin e stacionit te pompimit perfshin punime elektrike ne nje sasi te konsiderueshme dhe eshte e nevojshme qe keto punime te kryhen nen kujdesin e Inxhinierit Elektrik

Ne lidhje me kërkesen e Drejtuesit Teknik Inxhinier Mekanik njesia e prokurimit mbane ne konsiderate se projekti per perfshin punime mekanike ku perfshihen instalimet e pajisjeve te pompimit dhe eshte e nevojshme qe keto punime te kryhen nen kujdesin e Inxhinierit Mekanik.

Ne lidhje me kërkesen e Drejtuesit Teknik inxhinier Gjeodet, Njesia ka merre ne konsiderate dhe thekson se i gjithë piketimi do te kryhet nga Sipermarresi.

Ne lidhje me kërkesen e Drejtuesit Teknik Inxhinier Mjedisi njesia e prokurimit mbane ne konsiderate se projekti per perfshin punime shpyllezimi dhe eshte e nevojshme qe keto punime te kryhen nen kujdesin e Inxhinierit te Mjedisit.

Sa me siper analiza e ketyre te dhenave dhe kontrolli i nevojshem ne te gjithë etapat e punes qe kerkohet te realizohet, kerkon mimimalisht inxhinieret e kerkuar.

**2.3.5** Krahas stafit teknik Operoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- Teknik Ndertimi	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Mekanik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Elektricist	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Suvatues	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Murator	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Betonues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidrozolues	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Punonjes per prerje bimesh	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	3 (tre)	Leje Drejtimi
- Manovrator	1 (nje)	Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome e shkolles mesme/ Deshmitë profesionale/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperme te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Janar 2026 – Mars 2026.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk jane leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punonjesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certefikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cilat duhet te dorezohen ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Per stafin mbështetës, në lidhje me kualifikimet janë parashikuar nivele si Diplome e shkolles mesme/ Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/ Leje Drejtimi/ Deshmi te Aftesise Pofesionale (DAP) etj, te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga institucione shteterore, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

Po ashtu profilet e kerkuar dhe numri i tyre, janë kerkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë edhe zërat konkretë të preventivit të zbatimit të punimeve, volumit te tyre, Raportit Teknik dhe Specifikimet Teknike, si dhe mjeteve qe duhet te jene ne dispozicion, pasi parashikohen punime per rehabilitim te stacionit te pompimit.

Njesia e Prokurimit thekson se punimet konsistojne ne rehabilitimin e stacionit te pompimit te cilat do te kene nevojë per kryerjen e punimeve nga stafi mbeshtetes i kerkuar, kjo bazuar edhe ne zerat e preventivit te hartuar nga projektuesi.

Po ashtu, Njesia e Prokurimit thekson se duke marre ne konsiderate mjetet minimale te nevojshme per kryerjen e punimeve eshte perlllogaritur edhe numri i shofereve dhe manovratoreve qe duhen.

Sa me sipër me qellim realizimin e punimeve në përputhje me specifikimet teknike dhe zbatimin me sukses të kontratës si dhe kontrollin e nevojshëm në të gjithë etapat e punës që kërkohej të realizohet, kërkon minimalisht stafin e kërkuar.

**2.3.6** Operatorët Ekonomikë duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të pakten:

**2.3.6/a** -1 (nje) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për të përmbushur këto kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Janar 2026 – Mars 2026.

*Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 i ndryshuar dhe me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

**2.3.7** Operatorët Ekonomikë duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	Ne pronësi, qira ose kontratë bashkepunimi	Cope	2
2	Kamion me Vinc	Ne pronësi, qira ose kontratë bashkepunimi	Cope	1
3	Kamionçina me kapacitet mbajtës min 6 ton	Ne pronësi, qira ose kontratë bashkepunimi	Cope	1
4	Ekskavator me zingjir	Ne pronësi, qira ose kontratë bashkepunimi	Cope	1

5	Betoniere kantieri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	Cope	2
---	--------------------	--	------	---

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit: - certifikatën e pronesisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa për mjete të marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerases/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa për mjete të marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Njesia e prokurimit thekson se mjetet e transportit nevojiten per transportimin e materialeve te ndertimi.

Ndersa mjetet e germimit nevojiten per germimin e themeleve dhe sistemimin e ambienteve gjate punimeve per rikonstrukcionin e shkolles.

### **2.3.8 Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:**

#### **2.3.8/1 Per Materialet Elektrike dhe transformator:**

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

#### **2.3.8/2 Per Elektropompe horizontale centrifugale**

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ky kriter vendoset bazuar në zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rëndësi të veçantë të objektit të prokurimit, duke marrë në konsideratë se punimet konsistojnë në rehabilitimin e stacionit të pompimit.

Meqenëse punimet do të kryhen në një objekt që kërkon kujdes të veçantë për shkak të furnizimit me ujë për vaditje të zonës shfaqet e nevojshme që për mallrat që do të përdoren në realizimin e punimeve, Autoriteti Kontraktor të garantohet që këto mallra furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar dhe në cilësi të duhur.

**2.3.12** Operoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të lehuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 45001:2015**, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, ose ekuivalentin e saj

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar natyrës së veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet

e kërkuara të cilësisë sigurise ne pune. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Shenim: Per cdo emertim marke apo cilesie te shenuar ne preventivin e punimeve/specifikime teknike do te pranohet edhe ekuivalenti i tij.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Njesia pergjegjese ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne specifikimet teknike argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

#### **NJËSIA E PROKURIMIT**